



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 222, datë 08.05.2023

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATES FITUESE PËR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, VITI AKADEMIK 2021 – 2022, PROFILI KËSHILLTAR LIGJOR, ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 08.05.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin “Për procedurën e ndjekur në verifikimin e pasurisë dhe të figurës si dhe për rezultatet e kësaj procedure, në lidhje me kandidaten fituese në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022, profili këshilltar ligjor, z. {...}”, përgatitur nga relatorja e procedurës së verifikimit znj. Fatmira Luli, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin dhe lejimin e kandidates për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022, profili këshilltar ligjor;

VËREN:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} është kandidate për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili këshilltar ligjor dhe është vlerësuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të vendimit nr. 138, datë 02.04.2021, se i plotëson kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2021 – 2022, profili “këshilltar ligjor”, sipas nenit 34, pika 6, nenit 53, pika 4, dhe nenit 55, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si ligji “Për Pushtetin Gjyqësor”) si dhe në kreun V të Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor” (referuar në vijim si vendimi 424/2020).

2. Në funksion të verifikimit në kohë të pasurisë dhe figurës, duke qenë se kjo procedurë është e ndërvarur nga raportimet dhe informacionet e subjekteve publike dhe private që, sipas ligjit, duhet t'i dërgohen Këshillit, sipas vendimit nr. 501, datë 25.10.2021, "Për një shtesë në vendimin nr. 217, datë 26.05.2021, për fillimi e procedurës së verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për këshilltar dhe ndihmës ligjorë, viti akademik 2021-2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor" u vendos ky verifikim edhe për kandidaten si këshilltare ligjore znj. {...}. Në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës, për kandidaten znj. {...}, si relator u caktua z. Mehdi Bici.

3. Në datën 25.10.2021, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës;
- për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditor, kandidatja depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Në datën 02.11.2021, bazuar në pikat 65 dhe 66, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët fitues për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2021-2022.

6. Në datë 30.11.2021, u njoftua Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), për listën e kandidatëve për në programin e formimit fillestar, për të cilët do të kryhej deklarimi i pasurisë¹.

7. Brenda afatit treditor, kandidatja depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 2 javor ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin "Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë" pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

¹ Shih shkresën nr. 4948/1, datë 03.11.2021 drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

8. Gjatë procedurës së verifikimit, nga data 10.06.2021, bazuar në pikën 67/b, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2021-2022, ndër ta edhe për znj. {...}.

9. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Me vendimin nr. 9, datë 17.01.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e relatorit në procedurat e verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë shkollës së magjistraturës për këshilltarë dhe ndihmës ligjor, të papërfundura për shkak të mbarimit të mandatit të anëtarit të këshillit të lartë gjyqësor z. Medi Bici”, në bazë të shortit, për kandidaten znj. {...}, si relatore u caktua znj. Fatmira Luli.

11. Në datën 18.01.2022, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu XI, të Vendimit 424/2020, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:

- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

12. Brenda afatit treditör, znj. {...} nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e ri të caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT

A. Për verifikimin e pasurisë

13. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i pasurisë, sipas procedurës së përcaktuar në Seksionin B, të kreut VI, të vendimit 424/2020. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatjan, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor raportin “Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe të Interesave Privatë të kandidatjat për institucionet e sistemit të drejtësisë {...}, për pranimin në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës/Këshilltar Ligjor”, me nr. 522/24 prot., datë 10.01.2022².

² Depozituar në Këshill, me nr. 4948/4prot., datë 11.01.2022.

13.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidatja {...} dhe personi i lidhur Ilir Korbi (bashkëshorti), kanë plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

13.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti, në zbatim të nenit 3/1, të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare, të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, duke qenë se deklarata e e dorëzuar në datë 15.11.2021, nga kandidatja për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, {...} është brenda afatit 180 ditë nga kontrolli i ushtruar nga ILDKPKI, për Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të bashkëshorti të saj, kandidatit për Magjistrat profili Gjyqtar, Ilir Korbi, konkluzionet e dërguara pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me aktin nr. 522/23 prot., datë 16.09.2021, në të cilin është përfshirë pasuria dhe interesat private familjare, sipas nenit 7, pika 5 dhe 22, të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, janë të vlefshme edhe për kandidaten znj. {...}.

13.3 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare, të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për personin e lidhur Ilir Korbi (bashkëshorti i kandidates znj. {...}) :

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

14. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} dhe personin e lidhur Ilir Korbi (bashkëshorti) u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve³ dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave⁴.

14.1 Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresat me nr. 20184/1 prot., datë 18.11.2021 dhe nr. 12488/1 prot., datë 24.11.2021, kandidatja {...} dhe personi i lidhur Ilir Korbi (bashkëshorti) sipas të dhënave të sistemit informatik tatimor, nuk figurojnë të regjistruar si tatimpagues (për ushtrim aktiviteti privat në emër të tyre) si dhe nuk janë deklarues për DIVA (Deklarim Individual Vjetor i të Ardhurave Personale).

14.2 Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 20079/1 prot., datë 26.11.2021, për kandidaten {...} dhe personin e lidhur Ilir Korbi (bashkëshorti), nga verifikimet në sistemin elektronik të administrimit të të dhënave të këtij organi, për periudhën Mars 2004 deri në 17.11.2021, nuk rezultoi ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

³ Shkresa nr. 5129/4 prot., datë 05.11.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁴ Shkresa nr. 5129/3 prot., datë 05.11.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

15. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, u vlerësua se nuk kishte vend për t’i kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë për znj. {...}. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërorë dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, *“Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”,* i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

16. Sa më sipër, Këshilli konkludon se nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit të saj. Konkretisht, rezulton se :

- a) Kandidatja dhe personi i lidhur kanë plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) Kandidatja dhe personi i lidhur kanë plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) Kandidatja dhe personi i lidhur kanë burime financiare për të justifikuar pasuritë e tyre;
- ç) Deklarimi nga kandidatja dhe personi i lidhur i pasurisë, aseteve ose interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë referuar *“Deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, nr. nr. 522/24 prot., datë 10.01.2022.*

B. Për kriterin e figurës

17. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, sipas procedurës së përcaktuar në Seksionin C, të Kreut VI të vendimit 424/2020.

18. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe u verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...}, me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

19. Në kuadër të verifikimit të kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkuar dhe u depozitua rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 04.11.2021, formulari i vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr.138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,* si dhe autorizimi për Këshillin që, në zbatim të pikës 82, të Seksionit C, të Kreut VI, të vendimit 424/2020, të kryejë verifikimin në organet

kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin. Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, nga ana e Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit pranë KLGJ-së, janë kryer verifikimet e thelluara të të dhënave të formularit të vetëdeklarimit për gjendjen gjyqësore dhe gjendjen civile të kandidatës. Në vijim të përgjigjeve të shkresave të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme⁵, nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi u kryhen verifikimet e rastit, nuk u konstatuan mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit, duke konkluduar se znj. {...}: *“- ka dorëzuar formularin e vetdeklarimit më datë 04.11.2021; - formulari i vetdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web të KLGJ-së; - në formularin e vetdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nuk ka deklaruar gjeneralitete të mëparshme; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore, rezultoi i padënuar nga gjykatat penale shqiptare; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes civile, rezultoi se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”*. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

20. Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor⁶, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me shkresën nr. 1588/24 prot., datë 10.12.2021, përgjigjet zyrtare të **22** (njëzet e dy) prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve rezultoi se nga verifikimet e kryera nga të 22 prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, nuk rezultoi që kandidatja {...} të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj tij të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, ndaj tij të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara dhe të pezulluara.

21. Në përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me nr. 9012/1 prot, datë 12.11.2021⁷, pas verifikimit të regjistrimit të njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe të regjistrimit të njoftimit të veprave penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk rezultoi që ndaj kandidatës {...} të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Për sa më sipër, referuar dokumentacionit të administruar, nuk rezultojnë të dhëna se për kandidaten {...}, ka elementë të cënimit të figurës.

⁵ Shih shkresën nr. 5143/4 prot., datë 19.11.2021, të Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit.

⁶ Shkresa nr. 5129/6 prot., datë 05.11.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁷ Kthyer në bazë të shkresës kërkesë për informacion me nr. 5129/7 prot., datë 05.11.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

22. Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor⁸, Byroja Kombëtare e Hetimit, me shkresën nr.449 prot., datë 11.11.2021, nuk rezultuan të dhëna rreth figurës së kandidates {...}.

23. Nga procedura e zhvilluar për verifikimin në lidhje me kriterin e figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, rezulton se:

- a) Kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetë deklarimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015;
- b) Kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 83, Seksioni C, Kreu VI të vendimit 424/2020, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) Për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- d) Për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e saj, mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e saj për në formimin fillestar për këshilltar ligjor në Shkollën e Magjistraturës.

III. KONKLUSIONE

21. Referuar përcaktimeve të Vendimit 424/2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten për këshilltar ligjor, znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

22. Bazuar në sa është parashtruar më lart mbi rezultatet e verifikimit të pasurisë e figurës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush këto kritere dhe nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates fituese dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022, profili këshilltar ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 53, të ligjit nr. 98/2016, *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, 86 shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 115/2016, *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”*, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

⁸ Shkresa nr. 5129/1 prot., datë 05.11.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidates fituese znj. {...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022, profili këshilltar ligjor.
2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet kandidates, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR